



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës për informacion regjistruar me numër rendor 34 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 6229 prot., datë 04.12.2023, me anë të së cilës kërkonti vendosjen në dispozicion të praktikës së ndjekur për gjyqtaren {...} mbi largimin e saj nga detyra nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasojat e këtij vendimi, përbërjen e ish KLD dhe funksionimin e tij në vitin 1996, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me periudhën për të cilën kërkonti informacion dhe praktikën e ndjekur, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë dhe vendimet përkatëse.

Gjithashtu, sqarojmë se, për periudhën që ju kërkonti informacion dhe dokumentacion, më konkretisht për vitin 1996, për znj. {...}, emëruar me Vendimin nr. 14, datë 21.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtare pranë Gjykatës Fier, bazuar në Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezultoi se:

1. Me Vendimin nr. 7, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është liruar nga detyra për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës,
2. Me Vendimin nr. 8, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës Mallakastër.

Në përfundim ju bëjmë me dije se me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar nga organet e *vetting-ut*, me Vendimin nr. 348, datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!